



**PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË
ZGJEDHJEVE**

Nr. 17

Datë: 21. 05. 2019. Ora: 09:00

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë.

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ.

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Sami Hamiti, Florian Dushi, Adnan Rrustemi, Nazlije Bala, Ercan Spat, Alfred Kinolli, Čemailj Kurtišti.

SKQZ: Enis Halimi, Kryeshef i SKQZ.

Përkthyes: Vera Dula. Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së
2. Informatë nga QNR-ja lidhur me zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunitet: Mitrovicë e Veriut, Zveqan Lepsaviq dhe Zubin Potok.
3. Shqyrtimi i kërkesës së Kryetarit të Komunitetit të Kamenicës, për organizimin e referendumit konsultativ.
4. Formimi i panelit intervistues për pozitën e zëvendës Kryeshefit Ekzekutiv dhe Drejtorit Ekzekutiv të ZRPP-së.
5. Të ndryshme.

1. HYRJE: Valdete Daka, kryesuese e mbledhjes së KQZ-së

Valdete Daka: E keni rendin e ditës, a ka vërejtje..?

Florian Dushi: Mendoj që pika tretë “Shqyrtimi i kërkesës së Kryetarit të Komunitetit të Kamenicës, për organizimin e referendumit konsultativ”, ndoshta është dashur me kaluar, fillimisht nëpër këshillin për çështje ligjore.

Adnan Rrustemi: Po, patjetër...

Valdete Daka: Nuk kemi kompetencë...Ndërsa për pikën nr. 4 nuk kemi material.

Stevan Veselinoviq: Edhe pika e nr. 4 nuk është shkuar në këshill ligjor...

Valdete Daka: Kjo, është e përfunduar tashmë...Atëherë, kush është për këtë rend dite duke e hequr pikën e 3 –të...

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rendin e ditës.

2. Informatë nga QNR-ja lidhur me zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunat: Mitrovicë e Veriut, Zveqan Leposaviq dhe Zubin Potok

Enis Halimi: Siç e dini, pjesa më e madhe e procesit të punës përkitazi me zgjedhjet është bartur në QNR. Është pranuar materiali pa ndonjë problem, pra ka pasur pranim të rregullt të materialit. Në karantinë nuk është asnjë kuti. Puna në QNR po vazhdon, futja e të dhënave nga FRP –të ka mbaruar, kurse edhe skanimi i Listës Përfundimtare të Votuesve është duke u bërë sepse, kjo na ndihmon në procedimin e votave me kusht dhe për të vazhduar me numërimin e këtyre votave...

Pas përfundimit të të gjitha procedurave, do ti kemi edhe rezultatet finale.

Valdete Daka: Nuk kemi rezultate konkrete. Kur do të filloj numërimi...?

Enis Halimi: Tash për tash, deri sa të skanohet lista përfundimtare...

Valdete Daka: Kur do të fillojë numërimi... Sa vota janë me kusht, sa vota kanë ardhur nga jashtë, me postë... ? Kur do të filloj numërimi...? Ku janë pengesat..?

Enis Halimi: Është procedurë që po merr kohë...Nesër fillon numërimi i votave me kusht, kuptohet në bazë të dinamikës që kemi...

Florian Dushi: Ndryshe nga praktikat e kaluara, si KQZ i kemi marrë informacionet shumë vonë, sidomos për procedimin e materialit...Ka elemente për të kërkuar nga kryeshefi, dhe përmes tij nga koordinatori i QNR-së...

KQZ, duhet të informohet me kohë, kurse çështja tjetër është aspekti përmbajtjesor i informacioneve që ne duhet ti kemi me kohë...Është me rëndësi secili element, zhvillimi i proceseve, shifrat që ndërlidhen me procesin zgjedhor...

Valdete Daka: Është hera e parë që dy ditë pas mbarimit të zgjedhjeve nuk na ofrohen këto informata, duke marrë për bazë madje faktin që deri më tani nuk e kemi pasur asnjë problem... Pres që gjatë ditës të informohemi për këto që po i kërkojmë...

4.Formimi i panelit intervistues për pozitën e zëvendës Kryeshefit Ekzekutiv dhe Drejtorit Ekzekutiv të ZRPP-së

Valdete Daka: Lidhur me këtë pikë, a do ta mbyllim mbledhjen...? A do të vazhdojmë...? Si do të procedojmë...?

Sami Hamiti: Ne, do të vazhdojmë sigurisht, por kemi ardhur në një situatë kur dje na vjen mbas orës dy, imelli me të cilin duhet të vendosim “të nesërmen”, e që është sot...! Ne

s'kemi qenë të njoftuar, kurse Sekretariati komunikon mes vete...! Ne, do ta bëjmë sot...Dikujt, po intereson me dështuar konkursi...

Enis Halimi: Personeli, me datën 15 mua ma ka dërguar një shkresë, unë e kam e kam përcjellë te ju të njëjtën...Dje, përsëri e kam adresua te ju...
Unë nuk jam përfshirë, dhe nuk jam pjesë e procesit...

Valdete Daka: Ti je krye shef, dhe ti i menaxhon krejt këto...! Dhe janë detyra tuaja, edhe për informime, edhe për procedura që të njoftohen anëtarët...

E mbyllim mbledhjen, vazhdojmë më tutje...

3. Të ndryshme.